



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:164928

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06628583

C.nr1022/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtarin Nexhat Aliu dhe bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen juridike civile kontestimore të paditësit, K.H. nga fshati R. komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson V.M., avokat në Ferizaj, kundër të paditurave Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, (MBPZHR), të cilën përmes Avokaturës Shtetërore me autorizim e përfaqëson F.G.dhe e paditura Komuna e Vitisë, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, të cilën e përfaqëson Ardian Avdiu përfaqësues ligjor i komunës, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 8.750,00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, më datë 11.12.2024, mori, ndërsa me datë 19.12.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, K.H. nga fshati R., K. Viti, kundër të paditurave Qeveria e Republikës së Kosovës - MBPZHR dhe Komuna e Vitisë, i cili ka kërkuar t'i kompensohet dëmi në vlerën prej 8.750,00 €, i shkaktuar nga ngricat e hershme pranverore në perim kulturën dhe pemët në përgjithësi, për shkak të parashkrimit me kamatë ligjore prej 8%, nga data e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës.

II. Secila palë i bart vet shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, K.H. nga fshati R., komuna e Vitisë, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 25.11.2020, në këtë gjykatë, në fillim ka paditur Qeverinë e Republikës së Kosovës, MBPZHR, ndërsa më datë 14.01.2022, padinë e ka zgjeruar në kuptimin subjektiv, duke e paditur edhe Komunën e Vitisë – Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material, në vlerë prej 8.750,00 euro, i cili dëm i është shkaktuar me datat 20, 21 dhe 22 Prill të vitit 2017, në fidanet e perimeve dhe pemëve, për shkak të rënieve të temperaturave – ngricave, në pranverën e hershme, me kamatë ligjore prej 8%, nga

data e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas TOAK-së.

E paditura e parë, Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural më datë 27.07.2023, në përgjigjen e dhënë në padi, duke u bazuar në provat e bashkëngjitura, e ka kundërshtuar padinë e paditësit për kompensimin e dëmit, në vlerë prej 8.750,00 €, në kuptimin e legjitimitetit subjektiv real pasiv si të pa bazuar, po ashtu ka theksuar se MBPZHR, në ligjin, përkatësisht Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, nuk ishte ndarë fond për kompensimin eventual të dëmeve, në sektorin e bujqësisë. Ndërsa, lidhur me Raportin vlerësues për dëmin e shkaktuar, i përpiluar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Vitisë, ka theksuar se i njëjti nuk mund të prodhoj efekt juridik për të paditurën.

Sipas saj, ky raport, nuk përbën dokument përmbarues - titull ekzekutiv, në pajtim me dispozitat nga neni 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2, neni 24 paragrafi 1 dhe 3, neni 27 paragrafi i LIGJI NR. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, pasi që nga padia nuk mund të konkludohet kreditori dhe debitori, nuk dihet objekti i përmbarimit, nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, andaj i njëjti është i pa përmbarueshëm dhe nga gjykata ka kërkuar që të refuzohet padia dhe kërkesëpadija dhe parashtesa mbi zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv të paditësit, K.H. , në mungesë të legjitimitetit real pasiv, në raport me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, e paditura e dytë Komuna e Vitisë edhe pse në mënyrë të rregullt e kishte pranuar aktvendimin me shkresat e tjera në lënë, ajo përgjigje në padi nuk kishte dhënë fare.

Në seancën kryesore me datë 11.12.2024, përfaqësuesi i paditësit, av. V. M., ka theksuar se mbetet në tërësi pranë thënieve në padi dhe në parashtresën e ushtruar, për zgjerimin e padisë, në kuptimin subjektiv duke theksuar se nuk është kontestuese se paditësit i është shkaktuar dëmi, në të mbjellurat bujqesore përkasishte në molle, nga temperaturat e ulta dhe kjo vërtetohet nga raporti për vlersimin e demit i dt.04.05.2017, me nr.10-320/04-18012, ku është përpiluar ky raport nga ana e dy eksperteve profesional, ku është konstatuar vlere e demit e në të cilin raport vete shenohet nga e paditura e dytë për të paditurën e pare, fillimishte deri ne vitin 2020, keto raporte nuk ishin dorezuar paleve siq kërkohet me ligj, që palet e demtuara te posedon raportet me shkrim, për qka jan detyruar në vitin 2020, me liste me emrave te bujqeve të dëmtuar ti drejtohem Drejtorise për bujqesi në Komunën e Vitise, ashtu qe me dt.03.11.2020, Komuna e Vitise, perkasishte kryetari i komunes e kishte aprovuar kerkesen per qasjen e dokumenteve zyrtare perkasishte duke ju dorezuar edhe raportet per vlersimin e demit për secilin bujke të dëmtuar në baze të listes, ishte edhe emri i paditesit K.H., po ashtu ka pranuar pergjegjejen në padi e dhen nga e paditura dhe te njejten e kundershon si te pa bazuar dhe e pa arsyetuar nga se edhe pse kemi te beje me qeshtje kontestimore ne te njejten flitet per procedure permbarimore. Per qka i propozoi gjykates qe shqyrtimi gjyqesor te vazhdoi me administrimin e provave.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit te provave materjale konsideron se është vërtetuar baza juridike e kerkesepadise ku sa i perkete lartesi vlerse se kontestit veq është e percaktuar dhe e llogaritur nga e paditura e dyte, perkasishte komisioni profesional prej 3 antereve, i propozon gjyaktës që të miratoj kërkespadien e paditesit, dhe ti detyroj te paditurat që në menyre solidare paditesit te ia kompenzojme demin në lartesi prej 8.750,00 Euro te pesuar ne molle, me kamat ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit te padise në

Gjykate, dt. 25.11.2020, e deri ne pagese perfunditmare si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedures ne emer te taksave ligjore ne lartesi prej 62 Euro, ne emer të përpilimit të padise shume prej 104 Euro. Në emer të dy seance gjyqesore nga 135 euro për secilen, apo shumen e përgjithshem 270 Euro, po ashtu nese i referohemi përgjegjesis ne padi e paditura pare nuk e ka kontestuar qeshtjen e parashkrimit, po ashtu edhe ne raste se konsieron qeshtjen e parashkrimi kjo vërtetohet nga vendimi i zyres se kryetarit Komuna e Vitise, kur jan paisur me raportet per vlersimin e demit, që ky afate fillon te rrjedhe nga kjo date.

Përfaqësuesja e të paditurës Qeveria e Kosovës-MBPZHR, avokatja shtetërore F.G., ka thënë se e kundërshton padijen e paditesit e po ashtu konsideron se ka arritur parashkrim andaj e njejt duhet te hudhet si e pa lejueshme , nese gjykata e vleron te kunderten e kundërshtojme edhe sa i përkete objektit te padise me qense Ministrija MBPZHR nuk ka bere ekspertize apo vlersim të demit të pretenduar e po ashtu e as Komuna e Vitise, nuk ka pasur kompetence te vlersoi dëmin e pretenduar pa asnje baze ligjore. Andaj pas administrimin të provave i propozon gjykates që ta refuzoi në teresi kërkesëpadinë e paditësit.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave u vërtetuar se demi i pretenduar ka ndodhur me dt.20,21,22 te muajit prill 2017 ndersa padija është dorezuar në Gjykate me 25.11.2020, e qe si pas LMD është arritur parashkrimi pasi që afati për parashkrim rrjedhe nga koha e shkaktimit të demit , në kete raste për demin e pretenduar nga paditesi. Po ashtu nga administrimi i provave është vërtetuar se vlera e demit nuk është vërtetuar me asnje ekspertize nga vendi i ngjarjes dhe ase nuk ka pasur kompetence per vlersim te tille, pasi qe nuk ka pasur autorizim nga Ministrija per raportin si ne shkresat e lendese, i propozone gjykates që kërkesëpadin e paditësit ta refuzoi si të pas afatshme.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë, Komuna e Vitisë, Ardian Avdiu, e kishte kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe precizimin e padise, si nga aspekti i ligjimitet real pasiv dhe po ashtu për shkakt te parashkrimit. Pasi për dëmet e pretenduara të shkaktuar në prille të vitit 2017, padien e ka paraqitur me 25.11.2020, ndersa sa i përkete Komunes të Vitise me dt.23.12.2022, andaj konsideron se kerkesa eshte e parashkruar. Si prove i propozon vendimin e qeverise, nr.01/58 i dt.24.07.2018, i kundërshton provat e propozuara me arsyetimin se nuk jan relevante dhe nuk e vërtetojne themelsin e kërkesepadise, pasi se Komuna vetem se ju është përgjigjur kërkesës se paditësit për qasje në dokumentet dhe kjo nuk e bëne asesi përgjegjëse Komunen e Vitise për kompenzimin e këtyre dëmeve.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi me asnje prove nuk ka arritur te verteton pretendimet dhe kërkesat e tij, e as ligjimitetin real pasiv të komunes së Vitise lidhur me këte qeshtje, e po ashtu kërkesa e paditësit është e parashkruar konform nenit 357.1 te LMD. Andaj i propozon gjyakes që kërkesëpadin e paditësit ta refuzoi si të pa themelte dhe të pa bazuar, rrjedhimisht edhe shpenzimet e procedures.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

Raporti i Vlerësimit nr.10 i datës 04.05.2017, Vendimi për qasje në dokumentet zyrtare me emrat e fermerëve, aktvendimi i dt.03.11.2020, aktvendimi me nr.01/58, dt.24.07.2018 .

Gjykata në pajtim me nenin 8 të LPK-së ka bërë vlerësimin e provave veç e veç dhe si tërësi, andaj

- Nga Raporti i Vlerësimit nr.10, i datës 04.05.2017, vërtetohet se Komuna e Vitisë, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kishte përpiluar një Raport për dëmet e shkaktuara nga ngricat e vonshme pranëverore, në bazë të kërkesës nr.10-320/04-18012. Ky komision ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar se K.H., posedon një sipërfaqe prej 0.50 hektarësh të mbjella me mollë. Nga kjo sipërfaqe rendimenti i pritur ishte vlerësuar 25 ton mollë, të cilat janë dëmtuar në masë 70%. Vlerë kjo e llogaritur mbi bazën e parashikimeve për 0.50 ha = 50 tonë, në vlerën prej 0.50 € që e llogaritur në vlerë monetare është 8.750,00 (tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjet) euro.
- Nga Vendimi për qasje në dokumentet zyrtare nr.04-035/02-1098 i datës 04.11.2020, vërtetohet se Komuna e Vitisë, me datë 04.11.2020, duke vepruar sipas kërkesës së av. V.M., ka aprovuar kërkesën e të njëjtit për qasje në dokumentet zyrtare, në emër të palës së dëmtuar, nga fshati Lubishtë, komuna e Vitisë, ka miratuar kërkesën e të njëjtit.
- Nga Vendimi i Qeverisë nr.01/58 i datës 24.07.2018 të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar të datës dhe të plotësuar me Rregulloren nr.14/2017, me Rregulloren nr.15/2017, me Rregulloren nr.16/2017, pastaj nr.07/2018, si dhe me nenin 19 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerr vendim për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, në komunat e Kosovës dhe ishte autorizuar Ministria e Financave, për krijimin e një fondi të veçantë, për vitin 2019, për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë.

LIGJI NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjegjësisht neni 136 mbi bazën e përgjegjësisë, në paragrafin 1, thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa bën përkufizimin se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*. Në nenin 173 paragrafi 1, thuhet se *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”*.

Sipas nenit 357, për kërkesën e shpërblimit të dëmit, në paragrafin 1 thuhet, se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*, ndërsa nga shkresat e lëndës rezultojnë se K.H., përmes përfaqësuesit të tij, padinë e ka ushtruar me datë 25.11.2020, që i bie në një periudhë kohore pas tri vitesh e shtatë muajsh. Po ashtu i paqëndrueshëm është pretendimi i palës paditëse se Raportin e Vlerësimit të dëmit

Nga faktet e administruara, pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazës ligjore të cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Çështjet kryesore për gjykatën në këtë lëndë ishte përgjegjësia e të paditurave për kompensimin e dëmit. Për të paditurën e parë, përgjegjësia për kompensimin e dëmit, për të paditurën e dytë ishte çështja e legjitimiteti juridik real pasiv, në këtë çështje juridike civile, si dhe nëse kërkesa e paditësit ishte parashkruar.

Pala paditëse, pretendimin e saj, për kompensimin e dëmit e kishte mbështetur në Vendimi i Qeverisë nr.01/58 të datës 24.07.2018 të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar dhe të plotësuar me disa rregullore, si dhe me nenin 19 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, ku Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerr vendim për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, në komunat e

Kosovës dhe ishte autorizuar Ministria e Financave, për krijimin e një fondi të veçantë, për vitin 2019, për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë.

Për gjykatën, ky fakt nuk ishte provë relevante dhe nuk e bënë bindës pretendimin e palës paditëse se, Qeveria e Kosovës, gjegjësisht, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuar të paditësit, nga ngricat e hershme pranverore në vitin 2017. Kjo për faktin se, ky vendim kishte të bëjë me kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, në komunat e Kosovës dhe ishte autorizuar Ministria e Financave, për krijimin e një fondi të veçantë, për vitin 2019, për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, por se ky vendim nuk krijon detyrime për Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për kompensimin e dëmit të paditurit, të shkaktuar në prillin e vitit 2017.

Ky vendim në asnjë mënyrë nuk e obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pasi që ky vendim nuk kishte të bëjë fare me rastin konkret. Po ashtu, ky vendim, në asnjë mënyrë nuk e obligon Komunën e Vitisë, gjegjësisht, Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pasi siç u theksua më lartë, ky vendim ka krijuar obligime për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, për periudhën kohore të vitit 2019 dhe jo për periudhën e vitit 2017.

Gjykata, po ashtu, pretendimin e palës paditëse se Raporti i Vlerësimit nr.10, i datës 04.05.2017, me të cilin vërtetohet se Komuna e Vitisë, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, e kishte përpiluar për dëmet e shkaktuara nga ngricat e vonshme pranverore, në bazë të kërkesës nr.10-320/04-18012, nuk konsideron se krijon detyrim për palën e paditur, Komuna e Vitisë, për faktin se ky raport i krijuar nga komisioni në vendin e ngjarjes, ku është konstatuar se K.H. , posedon një sipërfaqe prej 0.50 hektarësh të mbjella me molla, nga kjo sipërfaqe pritej një rendiment prej 50 ton mollë, të cilat janë dëmtuar në masë prej 70%, kishte për qëllim vetëm vlerësimin e dëmit, dhe në rast të krijimit eventual të ndonjë fondi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për kompensim eventual, do të bëhej kompensimi i të njëjtit, por nuk krijon ndonjë detyrim për Komunën e Vitisë.

Gjykata, po ashtu, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësit është e parashkruar, për faktin se sipas nenit 357, për kërkesën e shpërblimit të dëmit, në paragrafin 1 thuhet, se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi padinë e ka ushtrua në 25 Nëntor 2020, ndërsa dëmi, të njëjtit i është shkaktuar në prill të vitit 2017, d.m.th. në një periudhë kohore më të gjatë se 3 vjetë e shtatë muaj.

Arsyetimi i palës paditëse me pretendimin se parashkrimi lidhur me këtë çështje duhet të fillojë nga data kur paditësi e ka marrë Raportin e Vlerësimit, për të cilin si provë ka propozuar Vendimin për qasje në dokumentet zyrtare nr.04-035/02-1098 të datës 04.11.2020, ku vërtetohet se Komuna e Vitisë, me datë 03.11.2020, duke vepruar sipas kërkesës së av. V.M., ka aprovuar kërkesën e të njëjtit për qasje në dokumentet zyrtare, në emër të palës së dëmtuar K.H., nga fshati R., komuna e Vitisë nuk e konsideron relevant për këtë çështje dhe nuk përbën arsye për mos fillimin e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, pasi që në nenin 357 decidivisht është theksuar se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*, dhe paditësi për dëmin ka qenë i njoftuar ditën që i është shkaktuar dëmi, ndërsa vlerësimi për dëmin, gjegjësisht Raporti i vlerësimit mund të prezantohej si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Sa i përket pretendimit të paditurës, Komuna e Vitisë, se nuk ka legjitimitet juridik real pasiv, për të qenë e paditur, gjykata e konsideron si të bazuar. Sepse, mbështetur në vendimin e Qeverisë nr.01/58 të datës 24.07.2018, në asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi nuk autorizohet apo detyrohet Komuna e Vitisë, për kompensimin e dëmeve, që do të thotë se përgjegjëse për kompensimin e dëmit është MBPZHR, në këtë vendim është saktësuar se detyrimet krijohen vetëm për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, për periudhën kohore të vitit 2019 dhe jo për periudhën e vitit 2017, me çka në asnjë mënyrë nuk bëhet përgjegjëse Komuna e Vitisë.

Gjykata konstaton se paditësi e ka humbur të drejtën e kërkesës së përmbushjes së detyrimit kompensues përmes padisë, për shkak të parashkrimit të kërkesës. Ky konstatim bazohet në thirrjen e vazhdueshme të palëve të paditura, duke e cituar edhe nenin 357 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimeve (LMD), Ligji Nr.04/L-077, andaj në rastin konkret paditësi ka humbur mundësinë e realizimit të kërkesës përmes gjykatës.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa të paditurat nuk i kanë kërkuar shpenzimet. Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C. nr.1022/2022, dt.19.12.2024**

G j y q t a r

i

Nexhat Aliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:164928
Datë: 19.12.2024
Numri i dokumentit: 06628583